



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/ Ministarstvo Obrazovanja, Nauke
i Tehnologije/ Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 0113/453
Datë: 04.10.2022

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 3 paragrafët 1, 2 dhe 3 dhe nenit 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Arsimin parauniversitar, si dhe nenit 8 paragrafit 1 nënparagrafit 1.4 Shtojcës 1 pika 7 e Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 8 paragrafi 7 i Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2022 për Kalendarin e vitit shkollor 2022-2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Kalendarit të vitit shkollor 2022-2023

1. Ndryshohet Kalendarin e vitit shkollor 2022-2023, për shkak të 22 ditëve të pambajtura të mësimit gjatë muajit shtator 2022 si pasojë e grevës së mësimdhënësve, si më poshtë:
 - 1.1. Tetë (8) ditë të mësimit të pambajtura për parafillor dhe klasat (1-8) sipas UA-05/2022 për Kalendarin e vitit shkollor 2022-2023 mbahen ditëve të shtune, si në vijim:
 - 1.1.1. Në muajin Tetor, 2022 më datat 15.10.2022, 22.10.2022 dhe 29.10.2022;
 - 1.1.2. Në muajin Nëntor, 2022 më datat 12.11.2022 dhe 26.11.2022;
 - 1.1.3. Në muajin Dhjetor, 2022 më datat 10.12.2022 dhe 24.12.2022;
 - 1.1.4. Në muajin Janar, 2023 me datë 14.01.2023.
2. Gjysmëvjeteri i parë për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar përfundon më datë 27.01.2023.
3. Pushimi dimëror për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar fillon më datë 30.01.2023 dhe mbaron më 03.02.2023.
4. Gjysmëvjeteri i dytë fillon më datë 06.02.2023.
5. Në pesë (5) ditë të planifikuara të pushimit pranveror sipas UA-05/2022, mbahet procesi mësimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.
6. Përfundimi i gjysmëvjeterit të dytë sipas klasave është si në vijim:

- 6.1. Për klasën e 12-të, (maturantët) më datë 05.06.2023;
 - 6.2. Për klasat 9, 10 dhe 11 më datë 27.06.2023;
 - 6.3. Për parafillor dhe klasat 1-8 më datë 30.06.2023.
7. Pikat 1 deri në pikën 6 të këtij vendimi, zbatohen për të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar të cilat kanë filluar procesin mësimor më datë 03.10.2022.
 8. Institucionet e arsimit parauniversitar që kanë filluar mësimin para datës 03.10.2022 obligohen që të bëjnë planifikimin dhe realizimin e ditëve të mësimit të përcaktuara më UA-05/2022.
 9. Institucionet e arsimit parauniversitar që kanë filluar mësimin më 1 shtator, vazhdojnë punën sipas UA-05/2022.
 10. Mësimdhënësit që kanë filluar mësimin para datës 03.10.2022 bëjnë planifikimin dhe realizimin e ditëve të mësimit, varësisht nga numri i orëve të pa mbajtura dhe informon drejtorin e shkollës.
 11. Institucionet e arsimit parauniversitar njoftojnë DKA-të për planifikimin e ditëve të mësimit sipas pikës 7 të këtij vendimi.
 12. Obligohen DKA-të dhe Institucionet e arsimit parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.
 13. Obligohet Inspektorati i Arsimit të mbikëqyrë zbatimin e këtij vendimi.
 14. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë si dhe nevojën për të plotësuar dhe ndryshuar kalendarin e vitit shkollor 2022-2023 si rezultat i grevës në muajin shtator 2022, është themeluar grupi punues për draftimin e këtij akti nënligjor me qëllim të evitimit të mos mbajtjes së secilës ditë mësimi të paraparë me UA 05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023. Grupi punues ka hartuar propozim aktin për plotësimin dhe ndryshimin e kalendarin brenda vitit shkollor duke riorganizuar 22 ditët e mos mbajtura gjatë muajit shtator. Ky akt është hartuar brenda autorizimit ligjor për plotësimin dhe ndryshimin e kalendarit e përcaktuar me nenin 8 paragrafin 7 të UA 05/2022. Andaj duke u bazuar në këtë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. DKA-ve;
2. Inspektoratit të arsimit;
3. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
4. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. Arkivit/MASHTI.


Ministre e MASHTI



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/ Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i
Tehnologije/ Ministry of Education, Science and Technology

Plotësimi dhe ndryshimi i Kalendarit të vitit shkollor 2022-2023
3.10.2022- 30.06.2023

Muaji	Periodha e ditëve të mësimit	Numri i ditëve të mësimit	Festat	Mbarimi i gjysmëvjetorëve dhe i vitit mësues
Tetor	3-31	21 ditë		
Nëntor	1-30	21 ditë	* Dita e shqiptarëve (Dita e Pavarësisë së Shqipërisë) 28.11.2022	
Dhjetor	1-30	21 ditë	*Krishtlindjet Katolike 25.12.2022	
			*Viti i Ri 2023 01.01.2023 dhe 02.01.2023	
Janar	4-27	17 ditë	* Krishtlindjet ortodokse 7.01.2023	
			27.01.2023 30.01.2023 - 3.02.2023	Përfundimi i gjysmëvjetorit të parë Pushimi Dimëror
Shkurt	6-28	16 ditë	*Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës 17.02.2023	
Mars	1-31	23 ditë		
Prill	3-28	17 ditë	* Dita e Kushtetutës 9.04.2023 * Pashkët Katolike 9.04.2023 * Pashkët Ortodokse 16.04.2023 * Fitër Bajrami 21.04.2023	
Maj	2-31	21 ditë	* Dita Ndërkombëtare e Punës 01.05.2023 * Dita e Evropës 9.05.2023	
Qershor	1-30	20 ditë	* Dita e Paqes 12.06.2023 * Kurban Bajrami 28.06.2023	-Përfundimi i vitit mësues për Klasën e 12-Maturantët me datë 5.06.2023 -Përfundimi i vitit mësues për klasën e 9, 10 dhe 11, më datë 27.06.2023 -Përfundimi i vitit mësues për parafillorët dhe klasat 1-8, më datë 30.06.2023

* 25.12.2022 Krishtlindjet katolike, ditë pushimi është më 26.12.2022.

* 01.01.2023 dhe 02.01.2023, ditë pushimi është më 02.01.2023 dhe 03.01.2023.

* 7.01.2023 Krishtlindjet ortodokse, ditë pushimi është më 9.01.2022.

* 9.04.2023 Dita e Kushtetutës, ditë pushimi është më 10.04.2023.

* 9.04.2023 Pashkët Katolike, ditë pushimi është më 10.04.2023.

* 16.04.2023 Pashkët Ortodokse, ditë pushimi është më 17.04.2023.

* Sipas datave të përcaktuara në këtë vendim, parafillorët dhe klasat (1-8), tetë ditë të pambajtura të mësimit i mbajnë të shtuneve.